



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.56, datë 28.10.2019

**PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME  
KËLCYRË SH.A.**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 28.10.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Këlcyre sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Këlcyre (**UK Këlcyre**) me shkresën nr. 26 prot. datë 14.11.2017 me lëndë "Kërkesë për licencim", shkresën nr. 50 prot. datë 10.08.2018 "Shkresë për plotësim dokumentacioni", shkresën nr. 27 prot. datë 31.07.2019 "Shkresë për plotësim dokumentacioni", shkresën nr. 30 prot. datë 30.09.2019 "Shkresë për plotësim dokumentacioni", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për herë të parë.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë për UK Këlcyre në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
  - a) Shoqëria UK Këlcyre ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 5 754 banorë në Bashkinë Këlcyre si më poshtë:

Zona e shërbimit me furnizim me ujë nga shoqëria UK Këlcyrë:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Këlcyrë	Popullsia në juridiksion	Popullsia e shërbyer
1	Këlcyrë	5 089	2 516
2	Deshnicë	2 600	1 204
3	Sukë+Ballaban	4 700	2 034
	<b>TOTALI</b>	<b>12 389 banorë</b>	<b>5 754 banorë</b>

- b) Drejtuese teknike e shoqërisë znj. Aldisa Durdaj mban titullin “Master Profesional në inxhinieri mjedisi datë 18.10.2016, pranë Universitetit Politeknik Tiranë.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të pare ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Këlcyrë, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Këlcyrë, rekomandon:
- Shoqëria UK Këlcyrë duhet të aplikojë pranë ERRU për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë.
  - Shoqëria UK Këlcyrë duhet të punojë në drejtim të zgjerimit të zonës së shërbimit në mënyrë që të gjithë banorët e Bashkisë Këlcyrë të marrin shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura nga kjo shoqëri me cilësi dhe brenda standardeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Këlcyrë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Këlcyrë sh.a me NUIS K49225204A në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik

